



-21-

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETARE I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN – BUNE

Adresa: Qendra Transferimit te Teknologjive Bujqesore.Kati 3-te,Cel.0682081245

Nr. 295 Prot.

Shkoder,dt. 26.12. 2007

INFORMACION

“MBI PERDORIMIN E BURIMIT UJORE LUMI DRIN
FSHATI ASHTE
PER PRODHIM TE ENERGJISE ELEKTRIKE
H/C ASHTE

Bazuar ne kerkesen e pa kerkuar te bere nga METE per perdorim te burimit uJOR LUMI DRIN per prodhim energjie elektrike, dhe se propozimi i mesiperm, sipas dokumentacionit qe disponon K.B.U. Drin-Bune, nuk ka te beje me projekte, per te cilat ka filluar apo eshte shpallur procedura e perzgjedhjes.

Sipas dokumentacionit te paraqitur nga METE, vepra e marrjes se ujit eshte ndertuar ne FSHATIN SPATHAR ne kuoten 21 m mbi nivelin e detit. Nepermjet nje kanali me gjatesi 5,5 km, uji do te dergohet ne ndertesen e H/C-se ne fshatin Ashte ne kuoten 11.4 m mbi nivelin e detit. Prej ketu me nje kanal 1, 3 km te gjate, uji do te kthehet perseri ne shtratin e lumit Drin. Prurja mesatare vjetore ne kete aks rezulton te jete 310 M3 /sek, ndersa konsumi maksimal i turbinave eshte $Q= 530$ M3/sek.

Ky informacion jepet nga K.B.U. Drin-Bune Shkoder, bazuar ne nenet 4, 5, 9 dhe 23 te ligjit nr. 9663 dt. 18.12.2006 “PER KONCESIONET”, dhe ne zbatim te tij te gernes b, pika 1, kreu IV, i V.K.M.-se nr. 27, dt. 19.01.2007, “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies se koncesioneve”, per plotesim dokumentacioni.

PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES
DRIN-BUNE

SEKRETARI


Ing. Osman DELTINA

KRYETARI


Maxhid CUNGU

